



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, më 22 qershor 2010
Nr. ref.: RK 28/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rasti nr. KI 17/09

Misin Beqiri

kundër

Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës, Misin Beqiri, jeton në fshatin Shtuticë, komuna e Drenasit.

Objekti i shqyrtimit

2. Parashtruesi i kërkesës pohon se për shkak të mungesës së zbatimit të vendimit të 29 qershorit 2007, të lëshuar nga Bordi Qendror i Ministrisë së Shëndetësisë për zbatimin e mjekimit jashtë vendit, është shkelur e drejta për trajtim mjekësor të fëmijës së tij të mitur.

Kopje e vërtetuar
Overena kopija
Certified Copy

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Kushtetuta); Neni 20 i Ligjit nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Ligji), dhe Neni 54(b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Rregullorja e punës).

Përmbledhje e procedurës në Gjykatë

4. Parashtruesi i kërkesës e parashtrori kërkesën e vet në Gjykatën Kushtetuese më 2 qershor 2009. Parashtruesi u informua të njëjtën ditë nga Sekretariati i Përkohshëm i Gjykatës, se rasti i tij do të shqyrtohet pasi Gjykata të bëhet tërësisht funksionale.
5. Më 18 dhjetor 2009, Gjykata Kushtetuese ia komunikoi Ministrisë së Shëndetësisë rastin e parashtruesit të kërkesës. Gjykata brenda afatit të përcaktuar ligjor, nuk mori asnjë përgjigje.
6. Më 13 maj 2010, Kolegji Shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit Raportues, Snezhana Botusharova, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, që rastin ta hedhë poshtë si të papranueshëm.

Faktet

7. Nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës shihet se e bija e tij e ndjerë e mitur, e lindur më 4 janar 2001, kishte vuajtur nga një gjendje e rëndë shëndetësore (*Dg. Leucosis acuta lymphoblastica*).
8. E bija e parashtruesit u hospitalizua në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë, prej 12 qershorit 2007 deri më 26 qershor 2007.
9. Më 27 qershor 2007, Qendra Klinike Universitare në Shkup, lëshoi një vërtetim sipas të cilit i tërë mjekimi i të bijës së parashtruesit të kërkesës, në spitalin e tyre do të kushtonte 30,000 euro.
10. Më 29 qershor 2007, Qendra Klinike Universitare në Prishtinë lëshoi një mendim se në bazë të diagnozës mjekësore, e bija e parashtruesit, do të duhej të dërgohej në një qendër më të avancuar mjekësore, jashtë vendit, për trajtim të mëtutjeshëm mjekësor.
11. Të njëjtën ditë, d.m.th. më 29 qershor 2009, Bordi Qendror për Zbatimin e Mjekimit Jashtë Vendit, lëshoi një vendim sipas të cilit shuma prej 30,000 eurove do të ndahej për trajtimin mjekësor në Shkup të së bijës së parashtruesit. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave e aprovuan këtë vendim po të njëjtën ditë.
12. Megjithatë, ky vendim kurrë nuk u zbatua.
13. Për shkak të mungesës së mbështetjes financiare nga qeveria, parashtruesi ishte i detyruar që vetë ta financonte trajtimin mjekësor të të bijës së vet në Itali, për çka i kishte ndihmuar KFOR-i italian. Më në fund, e bija e parashtruesit u dërgua për trajtim mjekësor në Romë.
14. Për fat të keq, më 18 tetor 2007, e bija e parashtruesit të kërkesës ndërroi jetë.

15. Më 30 nëntor 2007, parashtruesi paraqiti ankesë në zyrën e Ombudspersonit në Kosovë. Më pas, më 5 shtator 2008, Ombudspersoni ia komunikoi Ministrit të Shëndetësisë rastin e parashtruesit.

16. Në letrën dërguar Ministrit të Shëndetësisë, Ombudspersoni konkludoi se "ka pasur mungesë të transparencës lidhur me mjekimin jashtë vendit dhe urgjencën për marrjen e përgjigjes në lidhje me mundësinë e realizimit të kërkesës". Ombudspersoni më tutje theksoi se ai beson, që dështimi i Ministrisë së Shëndetësisë për të ofruar përgjigje dhe asistencë, si përgjigje ndaj kërkesës së parashtruesit, është shkelje e të drejtës për jetë siç parashihet me Nenin 2 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.

17. Më 23 shtator 2008, Ministria e Shëndetësisë iu përgjigj Ombudspersonit dhe theksoi, *inter alia*, se "mungesa e buxhetit për rastin (e bijës së parashtruesit) dhe gjasat e pakta për sukses, ishin faktorë që përcaktuan mosrealizimin e programit".

Pohimet e parashtruesit

18. Parashtruesi ankohet, pa përmendur asnjë dispozitë të posaçme të Kushtetutës, se është shkelur e drejta për trajtimin mjekësor të fëmijës së tij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të vendosur për kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet fillimisht të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe Ligj.

20. Gjykata Kushtetuese, vëren se parashtruesi u ankua se vendimi i Bordit Qendror për Zbatimin e Mjekimit Jashtë Vendi, i lëshuar më 29 qershor 2007, kurrë nuk ishte zbatuar.

21. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese vëren se ankesa e parashtruesit ka të bëjë me një periudhë që daton para datës së hyrjes në fuqi të Kushtetutës (shih Blecic v. Kroaci, kërkesa nr. 59532/00, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, 29 korrik 2004), prandaj, përfundon se kërkesa është e parashkruar.

22. Gjykata Kushtetuese gjithashtu rikujton që në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, *"individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

23. Edhe nëse supozohet që parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e vet me kohë, Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi nuk e ka mbështetur në asnjë mënyrë kur konsideron që mjetet ligjore, të parashikuara në Ligjin mbi Procedurën Administrative (Nr. 02/L-28, i 22 korrikut 2005) dhe/ose të Ligjit mbi Procedurën Përmbartimore (Nr. 2008/03-L008, i 2 qershorit 2008), nuk do të ishin në dispozicion dhe, po të ishin në dispozicion, nuk do të ishin efikase, prandaj, nuk duhet shteruar.

24. Prandaj, nuk mund të konsiderohet që parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmërinë e kërkesës së tij.

Kopje e vërtetuar
Overena kopija
Certified Copy

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit, si dhe Nenin 55 të Rregullores së punës, njëzëri,

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

Kopje e vërtetuar
Overena kopija
Certified Copy